



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 136/25 Dt. 20.02.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 8 dhe nenit 29 paragrafi 1.1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve (kërkesave) sipas njoftimit publik për mbështetje financiare të nënave lehona, që kanë lindur fëmijë gjatë vitit 2024. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Bajram Basha,.....kryesues,
 - 1.2. Erëza Badalli,anëtare,
 - 1.3. Vlora Dani,.....anëtare,
 - 1.4. Festim Shëndeti,.....anëtar,
 - 1.5. Ilirijane Vata,.....anëtare,
 - 1.6. Albulena Pulaj,.....anëtare rezervë.
- Detyrat e Komisionit janë të caktuara në Rregulloren MF–Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe ligjet dhe aktet të tjera nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
- Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komisioni dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Komisionit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

